# ГЛАСИЛО
# GAZETË

ЗЕЛС
BNJVL

ЈУНИ 2019
QERSHOR 2019





Почитувани,

Управниот одбор на ЗЕЛС во месец јуни реализираше средба со претседателот на Владата на Република Северна Македонија, Зоран Заев, на која присуствуваа и советници од неговиот Кабинет. На средбата беше договорена временската рамка за динамиката на активностите кои одат во насока од 1 јануари, 2020 година да започне реализација на нов бран во стратегискиот развој на децентрализацијата на локалната власт во земјава, обезбедување на поголема финансиска стабилност на единиците на локалната власт и фазно пренесување на надлежностите од централно на локално ниво, во областите каде ќе биде оценето дека е тоа можно и потребно. Во месец јуни, во Струга, седница одржа и највисокото тело на ЗЕЛС, Генералното собрание. Градоначалниците, како и претставниците на општинските совети кои се делегати на ова највисоко тело на ЗЕЛС, дискутираа за актуелните предизвици на локалната власт и го усвоија Финансискиот извештај на Заедницата за минатата година, како и одредени статутарни измени и дополнувања. Претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, во своето обраќање акцент стави на потребата единиците на локалната власт да бидат максимално самокритични во делот на собирањето на сопствените приходи, односно да преземат итни активности за комплетирање на базата на објекти кои се предмет на оданочување и да извршат репроценка на даночната основица, според актуелната методологија. Седница одржа и Надзорниот одбор на ЗЕЛС, каде, при разгледувањето на Финансискиот извештај, членовите ја нагласија важноста општините редовно да ја плаќаат членарината. Заедничкиот консултативен комитет помеѓу Република Северна Македонија и Комитетот на регионите на Европската Унија (ЗКК) овој месец го одржа шеснаесеттиот состанок во Брисел, на кој учествуваа и делегатите од ЗЕЛС. Се говореше за предизвиците, но и за напредокот на децентрализацијата во нашата земја, а една од двете теми беше посветена на јакнењето на доброто владеење. Членовите на Комисијата за урбанизам и просторно планирање при ЗЕЛС ја одржаа третата седница на која дискутираа за Предлог – законот за урбанистичко планирање, кој е во собраниска процедура. Седница одржа и Комисијата за следење на развојот на системот за финансирање на општините, каде, меѓу другото, беше констатирано дека локалните власти имаат потреба од повеќе финансиски средства за соодветно спроведување на надлежностите. Беа одржани и повеќе обуки со општинската администрација, како и работилница за советниците од тематската работна група за финансирање и буџет на тема „Партиципативно буџетирање и граѓански буџет". За сето тоа, но и за други активности што ЗЕЛС ги реализираше во месец јуни, поопширно ќе прочитате во јунскиот број на Гласилото на ЗЕЛС.

Со почит,
Душица Перишиќ
Извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Bordi drejtues i BNJVL-së në muajin qershor realizoi takim me kryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, në të cilin morën pjesë edhe këshilltarë nga kabineti i tij. Në takim u dakordua korniza kohore për dinamikën e aktiviteteve të cilat shkojnë në drejtim që nga 1 janari 2020 të fillojë realizimi i një vale të re në zhvillimin strategjik të decentralizimit të pushtetit lokal në vend, sigurimi i një stabiliteti më të madh financiar të njësive të pushtetit lokal dhe transferimi fazor i kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, në sferat ku do të vlerësohet se ajo gjë është e mundshme dhe e nevojshme. Në muajin qershor, në Strugë seancë mbajti edhe trupi më i lartë i BNJVL-së, Kuvendi gjeneral. Kryetarët e komunave, si dhe përfaqësuesit e këshillave komunale të cilët janë delegatë të këtij organi më të lartë të BNJVL-së diskutuan për sfidat aktuale të pushtetit lokal, miratuan Raportin financiar të Bashkësisë për vitin e kaluar, si dhe ndryshime dhe plotësime të caktuara statutore. Kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov në fjalimin e tij theksoi nevojën që njësitë e pushtetit lokal të jenë maksimalisht vetëkritike në pjesën e mbledhjes së të ardhurave vetanake, përkatësisht të ndërmarrin aktivitete urgjente për ta kompletuar bazën e objekteve që janë objekt të tatimit dhe të kryejnë rivlerësimin e bazës tatimore, sipas metodologjisë aktuale. Seancë mbajti edhe Bordi mbikëqyrës i BNJVL-së, ku gjatë shqyrtimit të Raportit financiar anëtarët theksuan rëndësinë se komunat duhet ta paguajnë rregullisht anëtarësinë. Komiteti i Përbashkët Konsultativ midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian (KPK) këtë muaj mbajtën takimin e gjashtëmbëdhjetë në Bruksel, na të cilin morën pjesë edhe delegatë nga BNJVL-ja. U diskutua për sfidat, por edhe për progresin e decentralizimit në vendin tonë, ndërsa një nga të dyja temat ishte kushtuar forcimit të qeverisjes së mirë. Anëtarët e Komisionit për urbanizëm dhe planifikim hapësinor të BNJVL-së mbajtën seancën e tretë në të cilën diskutuan për Draft – Ligjin për planifikim urbanistik, i cili është në procedurë parlamentare. Seancë mbajti edhe Komisioni për ndjekjen e zhvillimit të sistemit të financimit të komunave, ku mes tjerash u konstatua se autoritetet lokale kanë nevojë për më shumë mjete financiare për zbatim adekuat të kompetencave. U mbajtën edhe më shumë trajnime me administratën komunale, si dhe punëtoria për këshilltarë nga grupi tematik punues për financim dhe buxhet me temë "Buxhetimi participativ dhe buxheti qytetar". Për të gjitha këto, por edhe për aktivitete të tjera që i realizoi BNJVL-ja në muajin qershor, do të lexoni më gjerësisht në numrin e qershorit të Gazetës së BNJVL-së.

Me respekt
Dushica Perishiq
Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија
**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Славе Чорбев
**Лекторирал:** Момент мал ДООЕЛ,Скопје
**Дизајн и подготовка:** СОФИЈА ПРИНТ Богданци
**Печатење:** СОФИЈА ПРИНТ Богданци

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „ Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema - Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska - Dinkovska
**Përkthim:** Sllave Çorbev
**Lektoron:** Moment Mal SHPKNJP, Shkup
**Dizajnim dhe përgatitje:** SOFIJA PRINT Bogdanci
**Shtyp:** SOFIJA PRINT Bogdanci

## МРЕЖАТА НА ТППЕ ГИ КОМПЛЕТИРАШЕ СТАВОВИТЕ ВО ОБЛАСТА НА ПРОТИВПОЖАРНАТА ЗАШТИТА

Членовите на Мрежата на ТППЕ, при ЗЕЛС, одржаа состанок во просториите на Заедницата, на 29 мај, 2019 година. Претседателот на Мрежата и командант на ТППЕ на Град Скопје, Владимир Симоновски, ги информираше присутните за резултатите од средбата што тој ја имаше со Управниот одбор на ЗЕЛС, на која ги презентираше состојбите во противпожарната заштита, утврдени во таканаречениот документ „Отворени прашања". По подолга дискусија, присутните ги надополнија барањата со уште неколку заклучоци, односно ги донесоа усогласените ставовите во областа на противпожарната заштита.

Дополнување имаше во делот на утврдувањето на обврската за донесување на петгодишен план за инвестиции во противпожарните единици, а беше упатен и апел до општините кои немаат ТППЕ да потпишат договор за соработка и учество во финансирањето на ТППЕ со општините, каде истите единици се востановени, во согласност со Законот за пожарникарството. Исто така, беше нагласено и прашањето за староснатa граница на пожарникарите при прием на нов кадар, односно за надминување на проблемот со постојано „стареење" на структурата на вработените во ТППЕ. Членовите на Мрежата беа едногласни дека е потребно да се утврди методологија и критериуми за распределба на опремата и средствата на противпожарните единици од страна на ДЗС. Беше предложено да се извршат законски измени, односно при утврдувањето на стандардот за бројот на пожарникари, освен критериумот - број на жители, да се дополни и критериум за површина и број на населени места на територијата на ТППЕ. Беше предложено да се утврди и стандард за психофизичка и здравствена проверка на способноста на новите, но и на постојните кадри, согласно со искуствата што се применуваат од страна на МВР и АРСМ. Мрежата дискутираше и за потребата за повторно враќање на статусот на четирите противпожарни единици: Кривогаштани, Македонска Каменица, Ранковце и Ново Село, кои го изгубија статусот со измените на Законот за пожарникарство.

Во своите ставови претставниците на Мрежата на ТППЕ укажуваат на лошата состојба во ТППЕ, во однос на опремата и возилата, кои генерално се застарени, при што инсистираа на потребата од поголем износ на средства наменети за противпожарна заштита, врз основа на законот. Тие ги истакнаа проблемите со различната примена на прописите



## RRJETI I NJTZ-VE KOMPLETOI QËNDRIMET NË SFERËN E MBROJTJES NGA ZJARRI

Anëtarët e Rrjetit të NJTZ-ve të BNJVL-së mbajtën takim në hapësirat e Bashkësisë më 29 maj 2019. Kryetari i Rrjetit dhe komandant i NJTZ-së së Qytetit të Shkupit, Vlladimir Simonovski informoi të pranishmit për rezultatet e takimit që e pati ai me Bordin drejtues të BNJVL-së, në të cilin prezantoi gjendjet në mbrojtjen nga zjarri, të përcaktuara në dokumentin e ashtuquajtur "Çështje të hapura". Pas një diskutimi më të gjatë, të pranishmit i plotësuan kërkesat edhe me disa konkluzione të tjera, përkatësisht miratuan qëndrimet e harmonizuara në sferën e mbrojtjes nga zjarri.

Plotësim kishte në pjesën e përcaktimit të obligimit për miratimin e një plani pesëvjeçar të investimeve në njësitë e zjarrfikësve, ndërsa iu dërgua një apel komunave të cilat nuk kanë NJTZ të nënshkruajnë një kontratë për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në financimin e NJTZ-ve me komunat, ku të njëjtat njësi janë formuar në përputhje me Ligjin për zjarrfikje. Po ashtu u theksua edhe çështja për kufirin e moshës së zjarrfikësve gjatë pranimit të kuadrove të reja, përkatësisht për tejkalimin e problemit me "vjetërsimin" e mëtejshëm të strukturës së të punësuarve në NJTZ-të. Anëtarët e Rrjetit ishin unanim se duhet të përcaktohet metodologjia dhe kriteret për shpërndarjen e pajisjeve dhe mjeteve të njësive të zjarrfikësve nga ana e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit. U propozua të bëhen ndryshime ligjore, përkatësisht gjatë përcaktimit të standardit të numrit të zjarrfikësve, përveç kriterit të numrit të banorëve të plotësohet edhe kriteri për sipërfaqen dhe numrin e vendbanimeve në territorin e NJTZ-së. U propozua të përcaktohet edhe standardi për kontrollin psikofizik dhe shëndetësor të aftësisë së kuadrove të reja, por edhe të atyre ekzistuese në përputhje me përvojat që zbatohen nga ana e MPB-së dhe ARMV-së. Rrjeti diskutoi edhe për nevojën për kthimin e serishëm të statusit të katër njësive të zjarrfikësve: Krivogashtani, Makedonska Kamenica, Rankoci dhe Novosella, të cilat e humbën atë me ndryshimet e Ligjit për zjarrfikje.

Në qëndrimet e tyre, përfaqësuesit e Rrjetit të NJTZ-ve theksojnë gjendjen e keqe në NJTZ-të lidhur me pajisjet dhe automjetet, të cilat në përgjithësi janë të vjetra, me ç'rast insistonin për nevojën për një shumë më të madhe të mjeteve të dedikuara për mbrojtjen nga zjarri, në bazë të Ligjit. Ata theksuan problemet me zbatimin e ndryshëm të rregullave gjatë llogaritjes së rrogave





при пресметката на платите во различните општини, што доведува до голем број на покренати судски постапки за остварување на правото на плата и надоместоци на плата. Присутните ја нагласија и состојбата на преклопување на надлежностите на ЦУК и ДЗС, заради што беше предложена реорганизација на системот на противпожарна заштита, за обезбедување на поголема координираност на институциите, воспоставување на единствен информативен центар и центар за прием на повици за полиција, прва помош и пожар. Беше посочено дека за ангажирањата за извлекување и спасување од сообраќајни незгоди и при елементарни незгоди, потребна е дополнителна опрема, обука и стручни знаења на пожарникарите. Присутните повторно ја нагласија потребата од востановување на стручно – техничка насока во образовниот систем со степен на образование – пожарникар-техничар, како и потреба од воспоставување на тренинг центар за тековна обука и унапредување на способностите на пожарникарите.

Членовите на Мрежата го изнесоа впечатокот дека надлежните институциите не се ажурни во напорите да се уреди областа на противпожарната заштита и покрај бројните иницијативи што тие ги упатуваат до нив.

në komuna të ndryshme, që shkakton një numër të madh të procedurave të ngritura gjyqësore për realizimin e së drejtës së pagës dhe kompensimeve të pagës. Të pranishmit theksuan edhe gjendjen e përputhjes së kompetencave të Qendrës së Menaxhimit të Krizave dhe Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe për këtë arsye u propozua të bëhet riorganizim i sistemit të mbrojtjes nga zjarri, vendosje e një qendre të vetme informative dhe një qendre për pranim të thirrjeve të policisë, ndihmës së parë dhe shërbimit të zjarrfikësve. U theksua se për angazhimet për nxjerrje dhe shpëtim të personave nga aksidentet e trafikut dhe gjatë fatkeqësive elementare, nevojitet pajisje shtesë, trajnim dhe njohuri profesionale të zjarrfikësve. Të pranishmit theksuan përsëri nevojën për aplikimin e drejtimit profesional – teknik me shkallën e arsimit – zjarrfikës teknik, si dhe nevojën për themelimin e një qendre të trajnimit për trajnim dhe përmirësim të vazhdueshëm të aftësive të zjarrfikësve.

Anëtarët e Rrjetit theksuan përshtypjen se institucionet kompetente nuk janë këmbëngulës në përpjekjet që të rregullohet sfera e mbrojtjes nga zjarri edhe krahas iniciativave të shumta të cilat i drejtojnë ata deri te këto institucione.

## КОМИСИЈАТА ЗА УРБАНИЗАМ И ПРОСТОРНО ПЛАНИРАЊЕ ПРИ ЗЕЛС ЈА ОДРЖА СВОЈАТА ТРЕТА СЕДНИЦА

## KOMISIONI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR I BNJVL-SË MBAJTI SEANCËN E TIJ TË TRETË

На 6 јуни, во просториите на ЗЕЛС својата трета седница ја одржа Комисијата за урбанизам и просторно планирање, на која покрај членовите на оваа Комисија, поканетите стручни лица од општинската администрација, присуствуваше и проф. д-р. Мирослав Грчев, во својство на советник на претседателот на Владата за прашања од областа на урбанизмот и просторното планирање. Комисијата на оваа седница го разгледа текстот на Предлог – амандманите за изменување на текстот на Предлог – законот за урбанистичко планирање кој во моментот е во собраниска процедура на усвојување, а по кој е закажана и јавна расправа по донесена одлука на матичната комисија во Собранието која го разгледува овој Закон. Комисијата го разгледа и текстот на Нацрт – законот за градење, како и Правилникот за категоризација на градбите, изработен од проф. д-р. Грчев. Комисијата особено се задржа на прашањето за

Më 6 qershor, në hapësirat e BNJVL-së seancën e tij të tretë e mbajti Komisioni për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, në të cilën përveç anëtarëve të këtij Komisioni, personave të ftuar profesionalë nga administrata komunale, u ftua dhe mori pjesë edhe Prof. D-r. Mirosllav Gërçev, në cilësi të Këshilltarit të Kryetarit të Qeverisë për çështje të sferës së urbanizmit dhe planifikimit hapësinor. Komisioni në këtë seancë shqyrtoi tekstin e Propozim – Amendamenteve për ndryshimin e tekstit të Projekt – Ligjit për planifikim urbanistik, i cili është aktualisht në procedurë parlamentare për miratim dhe për të cilin është caktuar edhe debat publik pas Vendimit të marrë në Kuvend nga ana e Komisionit amë që e shqyrton këtë Ligj. Komisioni shqyrtoi edhe tekstin e Draft – Ligjit për ndërtim si dhe Rregulloren për kategorizimin e ndërtimeve, të përgatitur nga z-ri Gërçev. Komisioni sidomos i përkushtoi vëmendje çështjes



правото на општините да формираат сопствени јавни установи за планирање на просторот, како и потребните услови кои треба да се исполнат заради нивно формирање, како и прашањето за делокругот на нивната работа. Беше образложено дека приватните лиценцирани правни субјекти кои ја вршат оваа дејност, организирани при стопанските комори и Комората на архитекти и инженери, остро се спротивставуваат на ваквиот предлог од аспект на нарушување на принципите на лојална конкуренција, со оглед дека овие претпријатија ќе бидат субвенционирани од основачот – надлежната општина. Беше дискутирано и особено важното прашање за бесплатно користење на ажурираните катастарски подлоги наменети за изработување на урбанистички планови, но дека со законското решение се излегува во пресрет и на инсистирањето на Агенцијата за катастар на недвижности чиј извор на приходи е во голем дел финансиран од овој надомест, па оттука, општините нема да плаќаат надомест за користење на податоците за катастарските подлоги заради планирање на просторот само при изработување на планот со неговото донесување, додека секоја понатамошна измена ќе биде финансирана како и досега.

Со оглед дека во овој момент не е приоритетно прашањето за итно утврдување на конечна верзија на текстот на Законот за градење, Комисијата беше запознаена со главните карактеристики и опфатот на текстот на овој Закон, со обврска за идно дополнително активно вклучување во неговото понатамошно разработување.

për të drejtën e komunave për të formuar institucione të veta publike për planifikim të hapësirës si dhe kushtet e nevojshme të cilat duhet të përmbushen për shkak të formimit të tyre, si dhe çështjes për fushëveprimin e punës së tyre. U shpjegua se subjektet e licencuara private ligjore të cilat e kryejnë këtë veprimtari, të organizuara në kuadër të Odave ekonomike dhe Odës së arkitektëve dhe inxhinierëve, i kundërshtohen rreptësishtë këtij propozimi për shkak të thyerjes së principeve të konkurrencës lojale, duke marrë parasysh se këto ndërmarrje do të subvencionohen nga themeluesi – komuna kompetente. U diskutua edhe për çështjen shumë të rëndësishme për shfrytëzimin falas të bazave të azhuruara kadastrale të dedikuara për përgatitjen e planeve urbanistike, por se me Zgjidhjen ligjore mbështetet edhe insistimi i Agjencisë së Kadastrës së të Patundshmërive, burimi i së cilës të të ardhurave në pjesë të madhe financohet nga ky kompensim, kështu që komunat nuk do të paguajnë kompensim për shfrytëzimin e të dhënave për bazat kadastrale për shkak të planifikimit të hapësirës vetëm gjatë përgatitjes së planit me miratimin e tij, ndërsa çdo ndryshim i mëtejshëm do të financohet si deri më tani.

Duke pasur parasysh se në këtë moment nuk ka prioritet çështja për përcaktimin urgjent të versionit përfundimtar të tekstit të Ligjit për ndërtim, Komisioni u informua për karakteristikat kryesore dhe përmbajtjen e tekstit të këtij Ligji, me obligim që të përfshihet në të ardhmen në mënyrë aktive në shqyrtimin e tij të mëtejshëm.








Комисијата активно ќе се вклучи во јавните расправи организирани по обата закони, почнувајќи од првата јавна расправа организирана по повод Законот за урбанистичко планирање, каде ставовите на ЗЕЛС ќе ги образложи претседателот на оваа комисија во Собранието на државата.

Komisioni do të përfshihet në mënyrë aktive në debatet publike që do të organizohen për të dyja ligjet, duke filluar nga debati i parë publik që do të organizohet me rastin e Ligjit për planifikim urbanistik, ku qëndrimet e BNJVL-së do t'i shpjegojë Kryetari i këtij Komisioni në Kuvendin e shtetit.

## ПРЕТСТАВНИЦИ ОД ЛОКАЛНАТА ВЛАСТ ОД ЗЕМЈАВА УЧЕСТВУВАА НА ФОРУМОТ НА ГРАДОВИ И НА РЕГИОНИ, ВО ПОЛСКА

## PËRFAQËSUES NGA PUSHTETI LOKAL NGA VENDI MORËN PJESË NË FORUMIN E QYTETEVE DHE RAJONEVE NË POLONI

Под мотото „Инвестирање во Западен Балкан –инвестирање во Европа" од 4 до 6 јуни, 2019 година во Жежов (Република Полска) се одржа Форум на градови и на региони, организиран од Министерството за инвестиции и економски развој на Полска на кој присуствуваше градоначалникот на Делчево, Горан Трајковски, претседателот на Советот на општина Центар, Јана Белчева и заменик извршниот директор на ЗЕЛС, Ардита Дема Мехмети, како и делегација од Министерството за локална самоуправа, предводена од министерот Сухејл Фазлиу и претставници од НАЛАС.

Настанот е организиран во рамките на полското претседателство со Берлинскиот процес, во насока на приближување на земјите од Западен Балкан кон ЕУ. На Форумот беше нагласена иницијативата на агендата на Берлинскиот процес да се акцентира и улогата на локалните и регионалните власти, како и значењето на територијалната соработка, во пресрет на јулскиот самит во Познањ. Ова претставува голем чекор за доближување на Берлинскиот процес до реалните потреби на граѓаните на локално и на регионално ниво. Евидентно е значењето на

Me moton "Investimi në Ballkanin Perëndimor – Investim në Evropë", nga 4 deri më 6 qershor në Zhezhov (Republika e Polonisë) u mbajt Forumi i qyteteve dhe rajoneve të cilin e organizoi Ministria e Investimeve dhe Zhvillimit Ekonomik e Polonisë. Në Forum mori pjesë edhe kryetari i komunës së Dellçevës, Goran Trajkovski, kryetari i Këshillit të Komunës së Qendrës, Jana Bellçeva Andreevska dhe zëvendës-drejtoresha ekzekutive e BNJVL-së, Ardita Dema Mehmeti, si dhe një delegacion nga Ministria e Pushtetit Lokal, i udhëhequr nga ministri Suhejl Fazliu dhe përfaqësues të NALAS-it.

Ngjarja u organizua në kuadër të kryesimit polak me Procesin e Berlinit, në drejtim të përafrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së. Në Forum u theksua iniciativa e agjendës së Procesit të Berlinit që të theksohet edhe roli i autoriteteve lokale dhe rajonale, si dhe rëndësia e bashkëpunimit territorial, në prag të samitit të korrikut në Poznan. Ky është një hap i madh për përafrimin e Procesit të Berlinit deri te nevojat reale të qytetarëve në nivel lokal dhe rajonal. Është evidente rëndësia e





градовите и регионите како главни двигатели на развојот и носители на промените, преку воведување на нови иновативни методи во управувањето. На овој форум беа претставени неколку полски примери како од користење на европските фондови, така и беа споделени искуства и научени лекции на полските регионални и локални власти при користење на овие фондови, стекнати во петнаесетгодишното членство во ЕУ, напредокот, трансформациите, територијалната соработка и друго.

Една од поинтересните сесии, наменета за локалните власти, беше модерирана од страна на полската асоцијација на градовите, полската асоцијација на провинции и НАЛАС, каде беа споделени податоци и најдобри практики во однос на давањето на јавните услуги на локалните власти, а беа изнесени и информации од истражувањето „Можниот придонес на локалните власти од Југоисточна Европа на регионалната економска област".

qyteteve dhe rajoneve si iniciues kryesorë të zhvillimit dhe bartës të ndryshimeve përmes aplikimit të metodave të reja inovative të menaxhimit. Në këtë forum u prezantuan disa shembuj polakë, ndër të cilët edhe përdorimi i fondeve evropiane. U shpërndanë përvojat e autoriteteve polake rajonale dhe lokale gjatë përdorimit të këtyre fondeve nëpër anëtarësisë pesëmbëdhjetëvjeçare në BE, përparimi, transformimet, bashkëpunimi territorial dhe të tjera.

Një nga sesionet më interesante të dedikuara për autoritetet lokale ishte i moderuar nga ana e Asociacionit polak të qyteteve, Asociacionit polak të provincave dhe NALAS-it, ku u ndanë të dhëna dhe praktika më të mira të lidhura me dhënien e shërbimeve publike të autoriteteve lokale, ndërsa u prezantuan edhe informacione nga hulumtimi "Kontributi i mundshëm i autoriteteve lokale të Evropës juglindore në sferën rajonale ekonomike".

## ОПШТИНСКИ СОВЕТНИЦИ ПРОСЛЕДИЈА РАБОТИЛНИЦА НА ТЕМА „ПАРТИЦИПАТИВНО БУЏЕТИРАЊЕ И ГРАЃАНСКИ БУЏЕТ"

Околу дваесетина општински советници, кои изразија интересирање да учествуваат во тематската работна група „Финансирање и буџет во единиците од локалната самоуправа" на 10 јуни, 2019 година, во Скопје ја проследија работилницата„Партиципативно буџетирање и граѓански буџет". Станува збор за една од седумте работни групи составени од општински советници, од проектот „Зајакнување на општинските совети" што го реализира УНДП во соработка со ЗЕЛС. На оваа средба претседателката на Совет на општина Центар, Јана Белчева Андреевска, едногласно беше избрана за координатор на тематската работна група за финансирање и буџет во ЕЛС.

Граѓанскиот буџет овозможува поголема транспарентност и отчетност на локалната власт, Односно буџетските ставки на поедноставен и поразбирлив начин им се презентираат на граѓаните за тие полесно да разберат од каде се полни буџетот, како општината планира да ги потроши парите на граѓаните и колку средства планира за тоа... Целта е преку зголемување на информираноста на јавноста да се влијае врз посилно вклучување на граѓаните во креирањето на општинските програми и политики. Во таа насока, навременото започнување на процесот на консултација на општините со граѓаните при подготовка на годишните општински буџети, претставува една од поважните активности на локалната власт, каде важна улога имаат и членовите на Советот на општината. Советниците, исто така, беа запознаени со конкретните чекори на подготвување на граѓански буџет.

На работилницата беше потенцирана примената на особено значајната алатка за учество на граѓаните „ Форуми во заедницата". Се говореше за организацијата, принципите и начелата на „буџетските форуми", како алатка за непосредно учество на граѓаните во креирање на буџетските политики на ЕЛС. Беа пренесени и формите и начините на собирање на предлози од граѓаните во

## KËSHILLTARËT KOMUNALË NDOQËN PUNËTORINË ME TEMË "BUXHETIMI PARTICIPATIV DHE BUXHETI QYTETAR"

Rreth njëzet këshilltarësh komunalë, të cilët shprehën interesim për të marrë pjesë në grupin tematik punues "Financimi dhe buxheti në njësitë e vetëqeverisjes lokale" më 10 qershor 2019, në Shkup ndoqën punëtorinë "Buxhetimi participativ dhe buxheti qytetar". Bëhet fjalë për një nga shtatë grupet punuese të përbëra nga këshilltarë komunalë, që është pjesë e projektit "Përforcimi i këshillave komunale" që e realizon UNDP-ja në bashkëpunim me BNJVL. Në këtë takim, kryetarja e Këshillit të Komunës së Qendrës, Jana Bellçeva Andreevska u zgjidh njëzëri për koordinator të Grupit tematik punues për financim dhe buxhet në NJVL-të.

Buxheti qytetar mundëson një transparencë dhe llogaridhënie më të madhe të pushtetit lokal. Përkatësisht, pikat buxhetore u prezantohen në mënyrë më të thjeshtë dhe më të kuptueshme qytetarëve me qëllim që ata të kuptojnë më lehtë se nga mbushet buxheti, se si komuna planifikon t'i shpenzojë paratë e qytetarëve dhe sa mjete planifikon për atë. Qëllimi është që nëpërmjet rritjes së informimit të opinionit të ndikohet për një përfshirje më të madhe të qytetarëve në krijimin e programeve dhe politikave komunale. Në këtë drejtim, fillimi me kohë i procesit të konsultimit të komunave me qytetarët gjatë përgatitjes së buxheteve vjetore komunale është një nga aktivitetet më të rëndësishme të pushtetit lokal, ku një rol të rëndësishëm kanë edhe këshilltarët e Këshillit të komunës. Këshilltarët po ashtu u informuan për hapat konkretë të përgatitjes së buxhetit qytetar.

Në punëtorinë u theksua zbatimi i veglës shumë të rëndësishme për pjesëmarrjen e qytetarëve – "Forumet në bashkësi". U fol për organizimin, principet dhe parimet e "Forumeve buxhetore" si vegël për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në krijimin e politikave buxhetore të njësive të vetëqeverisjes lokale. U prezantuan edhe format dhe mënyrat e mbledhjes së propozimeve të qytetarëve në komunat, të cilat zakonisht realizohen



општините, кои претежно се реализираат преку средби во месните заедници. Од присутните произлегоа и одредени предлози за подобрување на целиот процес, меѓу кои локалната власт во текот на целата година да одржува средби со граѓаните на оваа , како и да се овозможат и on-line консултации. Притоа, беше нагласена и важноста од вклучување на невладиниот сектор во овие процеси. Исто така, беше посочено дека динамиката на форумскиот процес е усогласена со динамиката на буџетскиот календар, но со консултациите со граѓаните може да се започне и порано, доколку за тоа постои потреба и услови кај општините. Присутните беа информирани дека подетални информации и насоки за успешно спроведување на форумскиот процес, вклучително буџетските форуми може да се најдат во публикацијата „Прирачник – Форуми во заедницата во 11 чекори", изработен од страна на група експерти и објавен на веб - страницата на ЗЕЛС (www.zels.org.mk).

Присутните заклучија дека е потребна поголема вклученост и одговорност на општинската администрација при пренесување на барањата на граѓаните до советот и советниците (јасни, прецизни и навремено подготвени и споделени информации и материјали) и подетална подготовка на буџетските програми од страна општинската администрација и градоначалникот и нивно ефективно и разбирливо презентирање пред граѓаните.

Голем интерес кај присутни предизвика презентација на Мартин Соколовски, докторанд од Република Полска, истражувач во проектот LoGov во кој е вклучен и ЗЕЛС. Тој ги презентираше алатките и модалитетите на партиципативното буџетирање во Република Полска, со посебен осврт на таканаречениот „Селски фонд -Village fund" или "Sołecki fund". Во презентацијата тој истакна неколку иновативни начини на организирање на партиципативното буџетирање, како што е издвојувањето на одредена сума на финансии од општинскиот буџет за проекти од локален интерес, како и можноста за учество и на малолетните деца во креирањето на политиките на локално ниво. Тој потенцираше дека иницијативите за проекти на општините најчесто потекнуваат од граѓаните и граѓанскиот сектор.

përmes takimeve në bashkësitë lokale. Nga të pranishmit dolën edhe propozime të caktuara për përmirësimin e të gjithë procesit, ndër të cilat që pushteti lokal gjatë vitit të mbajë takime me qytetarët në këtë temë, si dhe të mundësohen edhe konsultime "on-line". Gjithashtu u theksua edhe rëndësia e përfshirjes së sektorit joqeveritar në këto procese. Po ashtu u theksua se dinamika e procesit të forumeve është harmonizuar me dinamikën e kalendarit buxhetor, por konsultimet me qytetarët mund të fillojnë edhe më herët, nëse komunat kanë nevojë dhe kushte për këtë. Të pranishmit u informuan se informata dhe udhëzime më të hollësishme për zbatimin e suksesshëm të procesit të forumeve, duke përfshirë forumet buxhetore, mund të gjenden në publikimin "Doracaku – Forumet në bashkësinë në 11 hapa", që është përgatitur nga ana e një grupi të ekspertëve dhe është publikuar në faqen e internetit të BNJVL-së (www.zels.org.mk).

Të pranishmit morën përfundim se ka nevojë për një përfshirje dhe përgjegjësi më të madhe të administratës komunale gjatë transferimit të kërkesave të qytetarëve deri te këshilli dhe këshilltarët (informacione dhe materiale të qarta, të sakta dhe të përgatitura dhe të ndara me kohë) dhe për një përgatitje më të hollësishme të programeve buxhetore nga ana e administratës komunale dhe kryetarit të komunës dhe për një prezantim të tyre efektiv dhe të kuptueshëm para qytetarëve.

Një interes të madh te të pranishmit shkaktoi prezantimi i Marçin Sokollovskit, doktorant nga Republika e Polonisë, hulumtues në projektin LoGov, në të cilin është përfshirë edhe BNJVL-ja. Ai prezantoi veglat dhe modalitetet e buxhetimit participativ në Republikën e Polonisë, me theks të veçantë për të ashtuquajturin "Fondi fshatar - Village fund" ose "Sołecki fund". Në prezantim, ai theksoi disa mënyra inovative të organizimit të buxhetimit participativ, siç është ndarja e një shume të caktuar të financave nga buxheti komunal për projekte të interesit lokal, si dhe mundësia për pjesëmarrje të fëmijëve adoleshentë në krijimin e politikave në nivel lokal. Ai theksoi se iniciativat për projekte në komunat më së shpeshti vijnë nga qytetarët ose sektori civil.

# РЕАЛИЗИРАНИ ОБУКИТЕ ЗА ИЗРАБОТКА НА ФУНКЦИОНАЛНА АНАЛИЗА НА ОПШТИНИТЕ

Пет општини ќе добијат менторска поддршка при изработката на документот „Функционална анализа на општината". Нивните имиња ќе бидат утврдени на почетокот на месец јули, а изборот ќе се направи од оние локални власти кои во доставените прашалници во претходниот период искажаа интерес да изработат ваков документ и истовремено учествуваа на обуките на кои беа објаснети методите и техниките за изработка на функционална анализа (ФА). Поддршката ќе започне од месец септември и се планира да биде реализирана до крајот на годинава. Со овие активности ќе се заокружи реализацијата на оној дел од проектот „Поддршка на процесите на демократско управување", што заеднички го реализираат ЗЕЛС и Мисијата на ОБСЕ во Скопје, посветен на јакнење на административните капацитетите на општините. Останатите општини кои ќе изразат дополнително барање за менторска поддршка во оваа област, ќе имаат можност таа поддршка да ја добијат следната година. Целта е сите општини квалитетно да ја реализираат законската обврска за изработката на функционалната анализа, која претставува алатка на раководството за подобрување на ефикасноста и ефективноста на извршувањето на работните задачи во рамките на внатрешната поставеност, како и за дистрибуцијата на расположливите ресурси (кадровски, просторни, ИТ, технички и др.) ФА, самата по себе, не предизвикува суштински промени, туку поставува рамка на сите потребни процеси на развој на капацитетите и на управувањето.

Во рамките на овој проект, во месец јуни беа одржани две дводневни обуки: едната на 12 и 13 јуни, 2019 година во Охрид, а другата на 20 и 21 јуни, 2019 година во Берово. Истородна обука беше одржана и во претходниот месец на 22 и 23 мај, 2019 година во Скопје, со што беа опфатени сите локални власти во земјава. Заинтересираноста на претставници од одделенијата за човечки ресурси од општините беше релативно голема. Дел од единиците на локалната власт веќе ја имаат реализирано оваа законска обврска, дел се во завршна фаза на подготвување на функционалната анализа, а има голем број општини кои воопшто не ја изработиле.

# U REALIZUAN TRAJNIMET PËR PËRGATITJEN E ANALIZËS FUNKSIONALE TË KOMUNAVE

Pesë komuna do të fitojnë mbështetjen e mentorimit gjatë përgatitjes së dokumentit "Analiza funksionale e komunës". Emrat e tyre do të përcaktohen në fillim të muajit korrik, ndërsa përzgjedhja do të bëhet nga ato autoritete lokale të cilat në pyetësorët e dërguar në periudhën e mëparshme kanë shprehur interes për të përgatitur një dokument të këtillë dhe njëkohësisht morën pjesë në trajnimet në të cilat u shpjeguan metodat dhe teknikat e përgatitjes së analizës funksionale (AF). Mbështetja do të fillojë në muajin shtator dhe planifikohet të realizohet deri në fund të vitit. Me këto aktivitete do të rrumbullakohet realizimi i asaj pjese të projektit "Mbështetja e proceseve të menaxhimit demokratik" që e realizuan bashkërisht BNJVL-ja dhe Misioni i OSBE-së në Shkup, të kushtuar për forcimin e kapaciteteve administrative të komunave. Komunat e tjera të cilat do të shprehin interes shtesë për mbështetjen e mentorimit në këtë sferë do të kenë mundësi për ta fituar atë në vitin e ardhshëm. Qëllimi është që të gjitha komunat ta realizojnë në mënyrë cilësore obligimin ligjor për përgatitjen e analizës funksionale, e cila është vegël e udhëheqjes për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kryerjes së detyrave të punës në kuadër të organizimit të brendshëm, si dhe për shpërndarjen e resurseve që janë në dispozicion (resurset kadrovike, hapësinore, informatike-teknologjike, teknike etj.). Analiza funksionale për vetveten nuk shkakton ndryshime thelbësore, por vendos një kornizë për të gjitha proceset e nevojshme të zhvillimit të kapaciteteve dhe të menaxhimit.

Në kuadër të këtij Projekti, në muajin qershor u mbajtën dy trajnime dyditore: njëri më 12 dhe 13 qershor 2019 në Ohër, ndërsa tjetri më 20 dhe 21 qershor në Berovë. Trajnim i njëjtë u mbajt edhe në muajin e mëparshëm më 22 dhe 23 maj 2019 në Shkup, me të cilin u përfshinë të gjitha autoritetet lokale në vend. Interesimi i përfaqësuesve të departamenteve të resurseve njerëzore të komunave ishte relativisht i lartë. Një pjesë e njësive të pushtetit lokal tashmë e kanë realizuar këtë obligim ligjor, një pjesë e tyre janë në fazën përfundimtare të përgatitjes së analizës funksionale, por një numër i madh i komunave fare nuk e kanë përgatitur



Овие обуки ќе им помогнат на сите општини квалитетно да го подготват или изработат овој документ и да ја следат правилноста во неговото натамошно реализирање. Секој од учесниците на овие обуки ќе добие сертификат за учество на обука за изработка на функционална анализа, што ќе биде доделен на заедничка средба на мрежата за УЧР при ЗЕЛС.

На сите три групи од овие дводневни обуки беше применет интерактивниот принцип на спроведување на обуката, при што учесниците имаа можност да искажат нивни примери, да укажат на состојбите во општините при изработката на актите за систематизација и внатрешна организација и да разменат искуства со своите колеги, како и да добијат одговори на одредени прашања од нивната секојдневна работа. Суштината на ФА е да ги идентификува предизвиците од организациски и функционален аспект, кои можат потенцијално да го отежнат или попречат остварувањето на актуелните надлежности и задачи на институцијата, но и оние кои се предвидуваат со стратешките документи и притоа да се предложат конкретни мерки за подобрување на исполнувањето на целите.

Обучувачите реализираа и повеќе практични вежби, со цел попрактично претставување на оваа алатка. Учесниците направија категоризација на активности и функции. Беше претставен моделот на функционалната анализа, кој се состои од проценка, направена според критериумите за стратегиска усогласеност со планираните цели, градење на организациските капацитети во институцијата и ефективно и ефикасно извршување на работните задачи за остварување на планираните резултати. Пред присутните беше детално претставена и методологијата за спроведување на ФА. Претставниците од локалната власт, на обуката, спроведоа и „интервју ", како дел од процесот на прибирање на информации за работењето на институцијата, а се запознаа и со начинот на пополнување на образецот за евалуација на функциите, како и со начинот на креирање на препораки од направената анализа на функциите. Учесниците посочија дека очекуваат ЗЕЛС тренинг центарот да продолжи со организирањето на ваков тип на обуки, кои во себе опфаќаат практични примери и изработка на документи.

atë. Këto trajnime do të ndihmojnë të gjitha komunat që ta përgatisin në mënyrë cilësore këtë dokument dhe ta ndjekin rregullshmërinë e realizimit të tij të mëtejshëm. Secili prej pjesëmarrësve të këtyre trajnimeve do të fitojë certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin për përgatitjen të analizës funksionale që do të jepet në takimin e përbashkët të rrjetit të menaxhimit të resurseve njerëzore pranë BNJVL-së.

Në të gjitha tri grupet e këtyre trajnimeve dyditore u zbatua principi interaktiv i zbatimit të trajnimit, kështu që pjesëmarrësit patën mundësinë t'i prezantojnë shembujt e tyre, të tregojnë gjendjet e komunave gjatë përgatitjes së akteve të sistematizimit dhe organizimit të brendshëm dhe të shkëmbejnë përvoja me kolegët e tyre, si dhe të fitojnë përgjigje për pyetje të caktuara të punës së tyre të përditshme. Thelbi i analizës funksionale është t'i identifikojë sfidat e aspektit organizativ dhe funksional, të cilat potencialisht mund ta vështirësojnë ose ta pengojnë realizimin e kompetencave dhe detyrave aktuale të institucionit, por edhe ato që parashihen me dokumentet strategjike dhe njëkohësisht të propozohen masa konkrete për të përmirësuar përmbushjen e qëllimeve dhe detyrave.

Trajnuesit zbatuan edhe disa ushtrime praktike me qëllim që ta prezantojnë më praktikisht këtë vegël. Pjesëmarrësit bënë një kategorizim të aktiviteteve dhe funksioneve. U prezantua modeli i analizës funksionale i cili përbëhet nga një vlerësim i bërë sipas kritereve të harmonizimit strategjik me qëllimet e planifikuara, ndërtimin e kapaciteteve organizative në institucion dhe kryerjen efektive dhe efikase të detyrave të punës për arritjen e rezultateve të planifikuara. Para të pranishmëve u prezantua hollësisht edhe metodologjia për zbatimin e analizës funksionale. Përfaqësuesit e pushtetit lokal zbatuan në trajnim edhe "intervistë" si pjesë e procesit të mbledhjes së informacioneve për punën e institucionit, ndërsa u informuan edhe për mënyrën e plotësimit të formularit për vlerësimin e funksioneve, si dhe për mënyrën e krijimit të rekomandimeve nga analiza e bërë e funksioneve. Pjesëmarrësit theksuan se presin që Qendra e Trajnimeve të BNJVL-së të vazhdojë me organizimin e llojit të këtillë të trajnimeve, të cilat përfshijnë shembujt praktikë dhe përgatitjen e dokumenteve.



## ПОГОЛЕМА ОДГОВОРНОСТ НА ЛОКАЛНИТЕ ВЛАСТИ ЗА СОБИРАЊЕ НА СОПСТВЕНИТЕ ПРИХОДИ - ЕДНА ОД ПРЕПОРАКИТЕ ИЗНЕСЕНИ НА ЧЕТВРТАТА СЕДНИЦА НА ГЕНЕРАЛНОТО СОБРАНИЕ НА ЗЕЛС

Генералното собрание на ЗЕЛС на 23 јуни, 2019 година во Струга ја одржа четвртата седница. Градоначалниците, како и претставниците на општинските совети, кои се делегати на ова највисоко тело на ЗЕЛС, дискутираа за актуелните предизвици на локалната власт, а го усвоија и Финансискиот извештај на Заедницата за минатата година, како и одредени статутарни измени и дополнувања. Претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, во своето обраќање пред делегатите најпрво ги апсолвираше позначајните активности што ЗЕЛС ги презеде минатата година, а потоа ги информираше за заедничките ставови што претходниот ден беа донесени на средбата што Управниот одбор на ЗЕЛС ја реализираше со претседателот на Владата на Република Северна Македонија, Зоран Заев.

Освен успесите на ЗЕЛС во лобирањето, Шилегов ги потенцираше и активностите на ЗЕЛС тренинг центарот, каде претходната година повеќе од 1680 претставници од општинската администрација минаа одредени обуки во рамките на шеснаесетте утврдени области што кореспондираат со одредени надлежности на локалната власт. Особено беа потенцирани обуките за полагање на испит за стекнување со овластување за водење постапка за отуѓување и давање под закуп на градежно земјиште, сопственост на државата, што според барањата на општините се организираа во три турнуси и на кои учествуваа вкупно 295 општински службеници. Со тоа се создава можност, што поголем број општини да го исполнат и овој услов и да ја преземат и оваа надлежност. Претседателот на ЗЕЛС говореше и за непреченото одвивање на активностите и на ЗЕЛС единицата за поддршка на електронските услуги за општините. „Стручните лица од оваа единица секојдневно им се на располагање на нашите вработени при користењето на информатичките системи за: градежна

## PËRGJEGJËSI MË E MADHE E AUTORITETEVE LOKALE PËR MBLEDHJEN E TË ARDHURAVE VETANAKE – NJË NGA REKOMANDIMET E NXJERRA NË SEANCËN E KATËRT TË KUVENDIT GJENERAL TË BNJVL-SË

Kuvendi gjeneral i BNJVL-së më 23 qershor 2019 në Strugë mbajti seancën e tij të katërt. Kryetarët e komunave, si dhe përfaqësuesit e këshillave komunale të cilët janë delegatë të këtij organi më të lartë të BNJVL-së diskutuan për sfidat aktuale të pushtetit lokal, ndërsa miratuan edhe Raportin financiar të Bashkësisë për vitin e kaluar, si dhe ndryshime dhe plotësime të caktuara statutore. Kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov në fjalimin e tij para delegatëve së pari përmendi aktivitetet më të rëndësishme që i ndërmori BNJVL-ja në vitin e kaluar dhe pastaj informoi ata për qëndrimet e përbashkëta që u miratuan ditën e mëparshme në takimin që e realizoi Bordi drejtues i BNJVL-së me Kryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev.

Përveç sukseseve të BNJVL-së në lobimin, Shilegov theksoi edhe aktivitetet e "Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së", ku vitin e kaluar më shumë se 1.680 përfaqësues nga administrata komunale kaluan trajnime të caktuara në kuadër të gjashtëmbëdhjetë sferave të përcaktuara që korrespondojnë me kompetenca të caktuara të pushtetit lokal. Sidomos u theksuan trajnimet për kalimin e provimit për marrjen e autorizimit për zbatimin e procedurës për shpronësim dhe dhënie me qira të tokës ndërtimore në pronësi të shtetit, të cilat, sipas kërkesave të komunave, u organizuan në tre cikla dhe në të cilat morën pjesë gjithsej 295 nëpunës komunalë. Me këtë krijohet mundësi që sa më shumë komuna ta përmbushin edhe këtë kusht dhe ta ndërmarrin edhe këtë kompetencë. Kryetari i BNJVL-së foli edhe për ecurinë e pandërprerë të aktiviteteve të "Njësisë së BNJVL-së për përkrahjen e shërbimeve elektronike për komunat". – "Personat profesionalë nga kjo njësi për çdo ditë janë në dispozicion të punonjësve tanë gjatë përdorimit të sistemeve informatike: për lejet e ndërtimit






дозвола, за е-ствари и за градежно земјиште. Бидејќи, одржувањето на информатичките системи и поддршката, во име на општините ја има ЗЕЛС, ние немаме никакви обврски освен да ги користиме, па токму затоа повторно ве потсетувам дека сите општини треба да ја плаќаме редовно членарината кон ЗЕЛС", нагласи Шилегов. Делегатите беа информирани и за меѓународната соработка со асоцијациите и со другите организации и тела кои се посветени на развојот на локалната власт. „Улогата на локалната власт во целиот процес на интегрирање на нашата земја во Унијата е многу значајна, бидејќи локалната власт е основата или почвата за развој на демократските процеси во секоја земја. Во таа насока ни претстои и голема одговорност. Уште сега треба да размислуваме и да дејствуваме како „европски општини". Треба да бидеме потранспарентни и отчетни, да ги поддржуваме и развиваме граѓанските иницијативи, да ја јакнеме свеста на нашите граѓани дека треба да бидат активни учесници во целиот процес на креирање и на донесување на локални одлуки", рече Шилегов. Тој ја нагласи потребата секоја општина да биде и максимално самокритична во делот на собирањето на сопствените приходи. „Мораме успешно да си ги собереме сопствените приходи, а не само да бараме средства од централната власт. Мораме редовно да ја надополнуваме базата на објекти кои се предмет на оданочување во општината и да извршиме репроценка на даночна основица според актуелната методологија. Потоа заеднички ќе воведеме правила според кои оние општини што целосно ќе го соберат данокот на имот, ќе имаат одредени привилегии: или ќе бидат ,,наградени" со дополнителни средства или ќе имаат предност при реализација на некои проекти. Општините кои тоа нема да го сторат, ќе бидат на некој начин ,,казнети". На седницата со свои дискусии и предлози се обратија и други делегати на Генералното собрание на ЗЕЛС. Беа посочени предизвиците на сè уште големата задолженост на повеќе јавни претпријатија чии основачи се општините, за што беше предложено да се формира посебна работна

për e-sende dhe për tokë ndërtimore. Sepse BNJVL-ja është përgjegjëse, në emër të komunave, për mirëmbajtjen dhe mbështetjen e sistemeve informatike, ne nuk kemi obligime të tjera përveç t'i përdorim ato dhe për këtë arsye ju kujtoj përsëri se të gjitha komunat duhet të paguajmë rregullisht anëtarësinë ndaj BNJVL-së", theksoi Shilegov.

Delegatët u informuan gjithashtu edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar me asociacionet dhe organizatat dhe trupat e tjerë që janë të përkushtuar për zhvillimin e pushtetit lokal. – "Roli i pushtetit lokal në të gjithë procesin e integrimit të vendin tonë në Union është shumë i rëndësishëm, sepse pushteti lokal është baza për zhvillimin e proceseve demokratike në secilin vend. Në këtë drejtim na pret një përgjegjësi e madhe. Që tani duhet të mendojmë dhe të veprojmë si "komuna evropiane". Duhet të jemi më transparentë dhe llogaridhënës, t'i mbështesim dhe t'i zhvillojmë iniciativat e qytetarëve, ta forcojmë vetëdijen e qytetarëve tanë se duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në të gjithë procesin e krijimit dhe marrjes së vendimeve lokale", tha Shilegov.

Ai theksoi nevojën që secila komunë të jetë maksimalisht vetëkritike në pjesën e mbledhjes së të ardhurave





група која прецизно ќе се посвети на утврдување на начини за надминување на овој голем финансиски предизвик. Беше потенциран и предизвикот со кој особено се соочуваат руралните општини, кој се однесува на недостаток на кадри за инспекциски служби, информатичари, урбанисти и слично. Недостатокот на урбанистички планови, особено долготрајната постапка за нивно донесување, како и понекогаш неадекватната постапка за заштита на културното наследство, претставуваат сериозни пречки на создавањето на услови за локален економски развој. Од страна на руралните општини беше посочено дека поради недостатокот на финансиски средства, овие општини се соочуваат со предизвик да не можат да го платат ДДВ-то при реализација на проекти за локални патишта или при аплицирањето на проекти на домашни и странски фондови. Седницата заврши со препорака дека на локалните власти им претстои период на сериозни преиспитувања за утврдување на натамошниот процес на децентрализацијата, каде ќе се креираат и ќе се носат сериозни одлуки, поради што е потребна поголема посветеност и одговорност од сите општини. Се очекува дефинитивно за локалната власт да се обезбеди поголема финансиска самостојност, како и нови надлежности, но тоа подразбира и поголеми одговорности и засилено темпо на активности.



vetanake. - "Duhet ta plotësojmë rregullisht bazën e objekteve që janë objekt i tatimit në komunë dhe të bëjmë rivlerësim të bazës tatimore sipas metodologjisë aktuale. Pastaj do të aplikojmë bashkërisht rregulla, sipas të cilave, ato komuna të cilat do ta mbledhin tërësisht tatimin e pronës, do të kenë privilegje të caktuara: ose do të "shpërblehen" me mjete shtesë ose do të kenë përparësi gjatë realizimit të projekteve të caktuara. Komunat të cilat nuk do ta bëjnë atë, do të "ndëshkohen" në njëfarë mënyre.

Në seancë me diskutime dhe propozime të veta u drejtuan edhe delegatë të tjerë të Kuvendit gjeneral të BNJVL-së. U theksuan sfidat për borxhet e mëdha që i kanë ende më shumë ndërmarrje publike të themeluara nga komunat, për të cilën gjë u propozua të formohet një grup i veçantë punues i cili do të përkushtohet në mënyrë precize për gjetjen e mënyrave të tejkalimit të kësaj sfide të madhe financiare. U theksua edhe sfida me të cilën ballafaqohen sidomos komunat rurale, e cila ka të bëjë me mungesën e kuadrove për shërbime inspektuese, informaticientë, urbanistë etj. Mungesa e planeve urbanistike, sidomos procedura e gjatë për miratimin e tyre, si dhe nganjëherë procedura joadekuate për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë pengesa serioze të krijimit të kushteve për zhvillimin ekonomik lokal. Nga ana e komunave rurale u theksua se për shkak të mungesës së mjeteve financiare, këto komuna ballafaqohen me sfidën e pamundësisë për ta paguar TVSH-në gjatë realizimit të projekteve për rrugët lokale ose gjatë aplikimit të projekteve në fondet vendase dhe të huaja.

Seanca mbaroi me rekomandim se autoritetet lokale i pret një periudhë e rishikimeve serioze për përcaktimin e procesit të mëtejshëm të decentralizimit, ku do të krijohen dhe do të miratohen vendime serioze dhe për këtë arsye nevojitet një përkushtim dhe përgjegjësi më e madhe nga të gjitha komunat. Pritet që definitivisht për pushtetin lokal të sigurohet një pavarësi më e madhe financiare, si dhe kompetenca të reja, por kjo do të thotë edhe përgjegjësi më të mëdha dhe një ritëm më të fortë të aktiviteteve.


BNJVL


BNJVL













## СТАРТУВААТ ПРОЕКТИТЕ СО ОДРЖЛИВО УРБАНО ПЛАНИРАЊЕ

Општините Карпош и Охрид до средината на септември треба да ги реализираат проектите за кои ќе добијат грант, во износ од по 7.500,00 евра (бруто) од проектот „Поддршка на локалните самоуправи на Република Северна Македонија во промоција на одржливо урбано планирање" што го реализира ЗЕЛС, во соработка со Германската агенција за меѓународен развој (ГИЗ). Станува збор за проекти во кои се користат мерки и нови пристапи во урбаното планирање и сообраќај на локално ниво (Sustainable urban mobility planning- SUMP).

Општина Карпош имплементира проект поврзан со обновливи извори на енергија (сончеви колектори) за напојување на електрични скутери и други уреди во Адреналинскиот парк во општина Карпош. Во рамките на проектот предвидена е и реконструкција и поставување на нови велосипедски патеки во должина од 2 км во просторот помеѓу Адреналинскиот парк и Спортско- рекреативната зона Влае. Општината дополнително ќе набави и пет електрични скутери кои ќе се напојуваат од поставените обновливи извори на енергија.

Општина Охрид, пак, планира стимулирање на користењето на велосипеди на својата територија со што ќе создаде услови со поставување на т.н. „паркинг места за велосипеди" на неколку локации во и надвор од градот. Поточно предвидени се локации во самиот центар на градот, како и на локации во близина на плажите на Охридското Езеро.

Во рамките на проектот од почетокот на јули ќе започне и експертската поддршка за општините: Битола, Карпош, Кавадарци, Куманово и Охрид за стратешко планирање за одржлива урбана мобилност. Проектот претставува иницијатива за промоција, за планирање и за градење на капацитетите во локалната власт за спроведување на активности за урбана мобилност, што ќе се темелат на модел на оптимални трошоци и иновативност, како и зголемување на удобноста на живеењето на граѓаните. Кај урбаното мобилно планирање, во фокусот е ставен граѓанинот. Со ваквото планирање се нагласува потребата од поголем простор за нив, зеленило, подобрување на јавниот превоз и на условите за користење на велосипеди, воспоставување на забранети зони за сообраќај, потоа користење на катни паркиралишта и друго. Одржливата урбана мобилност е нова област на делување во локалната власт во РСМ, иако е воспоставена практика во Европската Унија. Досега, многу европски градови имаат имплементирано вакви урбани планови. Затоа, целта на проектот е да се стимулира користење на одржливо урбани мерки и во нашата земја, за разлика од традиционалното планирање, каде главната цел е ставена на протокот и брзината на сообраќајот, а не на удобноста на просторот за граѓанинот. Токму на оваа тема во Гронинген, Холандија, од 17 до 19 јуни, 2019 година се одржа шестата Европска конференција за одржливо урбано планирање, под покровителство на Европската Унија, каде водечките

## FILLOJNË PROJEKTET PËR PLANIFIKIM TË QËNDRUESHËM URBAN

Komunat e Karposhit dhe Ohrit deri në mesin e muajit shtator duhet t'i realizojnë projektet për të cilat do të fitojnë grant në vlerë prej nga 7.500,00 Euro (bruto) nga projekti "Përkrahja e vetëqeverisjeve lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për promovimin e planifikimit të qëndrueshëm urban" që e realizon BNJVL-ja në bashkëpunim me Agjencinë gjermane për zhvillim ndërkombëtar (GIZ). Bëhet fjalë për projekte në të cilat përdoren masa dhe qasje të reja në planifikimin urban dhe trafik në nivel lokal (Sustainable urban mobility planning - SUMP).

Komuna e Karposhit zbaton një projekt të lidhur me burime të ripërtëritshme të energjisë (kolektorë diellorë) për furnizim me energji elektrike të skuterëve elektrikë dhe pajisjeve të tjera në Parkun e adrenalinës në Komunën e Karposhit. Në kuadër të projektit është paraparë edhe rekonstruksioni dhe vendosja e shtigjeve të reja për biçikleta në gjatësi prej 2 km në hapësirën midis Parkun e adrenalinës dhe Zonës sportive rekreative Vllae. Komuna do të blejë në mënyrë shtesë edhe pesë skuterë elektrikë të cilët do të furnizohen me energji elektrike në burimet e vendosura të ripërtëritshme të energjisë.

Komuna e Ohrit planifikon të stimulojë përdorimin e biçikletave në territorin e saj me ç'rast do të krijohen kushte për vendosjen e të ashtuquajturave "parking vende për biçikleta" në disa lokacione brenda dhe jashtë qytetit. Më saktësisht, janë paraparë lokacione në qendrën e qytetit, si dhe në lokacione në afërsi të plazheve të Liqenit të Ohrit.

Në kuadër të projektit, nga fillimi i korrikut do të fillojë edhe përkrahja e ekspertëve për komunat: Manastir, Karposh, Kavadar, Kumanovë dhe Ohër për planifikimin strategjik të mobilitetit të qëndrueshëm urban. Projekti është iniciativë për promovim, planifikim dhe ndërtim të kapaciteteve të pushtetit lokal për zbatimin e aktiviteteve të mobilitetit urban, që do të bazohen në modelin e shpenzimeve optimale dhe inovacionit, si dhe për rritjen e komoditetit të jetesës së qytetarëve. Qyteti është në fokusin e planifikimit mobil urban. Me planifikimin e këtillë theksohet nevoja për hapësirë më të madhe për ta, për gjelbërim, për përmirësim të transportit publik dhe të kushteve për përdorimin e biçikletave, për vendosjen e zonave të ndaluara për trafik, pastaj për përdorim të parkingjeve me kate etj. Mobiliteti i qëndrueshëm urban është një sferë e re e veprimit të pushtetit lokal në RMV, edhe pse kjo është praktikë në Bashkimin Evropian. Deri më tani, shumë qytete evropiane kanë zbatuar plane të këtilla urbane. Prandaj, qëllimi i projektit është që të stimulohet përdorimi i masave të qëndrueshme urbane edhe në vendin tonë, për dallim nga planifikimi tradicional, ku qëllimi kryesor është vënë në rrjedhën dhe shpejtësinë e trafikut, e jo në komoditetin e hapësirës së qytetarit. Pikërisht me këtë temë në Groningen – Holandë, prej 17 deri më 19 qershor u mbajt Konferenca e gjashtë evropiane për planifikim të qëndrueshëm urban, me organizim të Bashkimit Evropian,

градови во оваа област ги споделуваат своите практики и искуства со останатите европски градови и со градовите од земјите од Југоисточна Европа. На конференцијата се претстави и градот домаќин кој го носи епитетот „европска престолнина на велосипедистите". Во него 64% од сообраќајот се врши со велосипеди, а останатите 36% се пешаци и возила. Всушност сообраќајната инфраструктура во градот е поставена така што предност во сообраќајот имаат велосипедистите. Во последните години направен е и таканаречен „автопат за велосипеди" кој обезбедува поврзување со соседните градови и со студентските кампуси на кои исклучиво превозно средство е велосипедот.

Повеќе информации и публикации може да преземете од веб-страницата на ЗЕЛС, во делот на одржлива урбана мобилност.




ku qytetet liderë në këtë sferë të cilat ndajnë praktikat dhe përvojat e tyre me qytetet e tjera evropiane dhe me qytetet e vendeve të Evropës juglindore. Në konferencë u prezantua edhe qyteti nikoqir i cili mban epitetin "Kryeqyteti evropian i biçikletave". Në të 64% e trafikut zhvillohet me biçikleta, ndërsa 36% të tjera nga këmbësorë dhe automjete. Në fakt, infrastruktura e trafikut në qytet është vendosur kështu që përparësinë në trafik e kanë çiklistët. Në vitet e fundit është bërë edhe e ashtuquajtura "autostrada për biçikleta" e cila siguron lidhjen me qytetet fqinje dhe kampet studentore, ku mjeti ivetëm transportues është – biçikleta.

Më shumë informacione dhe publikime mund të shkarkoni nga faqja e internetit të BNJVL-së në pjesën e mobilitetit të qëndrueshëm urban.

## ЛОКАЛНАТА И ЦЕНТРАЛНАТА ВЛАСТ ЌЕ РАБОТАТ НА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ НА НОВ БРАН НА ДЕЦЕНТРАЛИЗАЦИЈА ВО ЗЕМЈАВА

## PUSHTETI LOKAL DHE QENDROR DO TË PUNOJNË PËR TË SIGURUAR NJË VALË TË RE TË DECENTRALIZIMIT NË VEND

Од 1 јануари, 2020 година се очекува да започне реализацијата на нов бран во стратегискиот развој на децентрализацијата на локалната власт во земјава. Се предвидува обезбедување на поголема финансиска стабилност на единиците на локалната власт и фазно пренесување на надлежности од централно на локално ниво, во областите каде ќе биде оценето дека е тоа можно и потребно.

Ова беше генералниот заклучок од средбата што Управниот одбор на ЗЕЛС ја реализираше со претседателот на Владата на Република Северна Македонија, Зоран Заев, на 22 јуни, 2019 година, во Струга, на која присуствуваа и советници од неговиот Кабинет, задолжени за ресорите коишто се

Nga 1 janar 2020 pritet të fillojë realizimi i valës së re në zhvillimin strategjik të decentralizimit të pushtetit lokal në vend. Sigurimi i një stabiliteti më të madh financiar të njësive të pushtetit lokal dhe transferimi fazor i kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, në sferat ku do të vlerësohet se ajo gjë është e mundshme dhe e nevojshme.

Ky ishte konkluzioni i përgjithshëm i takimit që e realizoi Bordi drejtues i BNJVL-së me Kryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, më 22 qershor 2019, në Strugë, në të cilin morën pjesë edhe këshilltarë nga kabineti i tij, të detyruar për resorët të cilët





важни за функционирањето на локалната самоуправа. На оваа средба беше договорена и временската рамка и динамиката за реализацијата на обврските. Беше утврдено да се формира мала оперативна група со претставници од двете страни, кои до крајот на јули ќе работат на темите за промени во процесот на децентрализацијата, со цел преземање на понатамошни законски измени за обезбедување на нивна објективна реализација.

Барањата на локалните власти ги изнесе претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, на почетокот на средбата. Станува збор за систематизираните ставови на ЗЕЛС, кои беа ревидирани уште минатата година и кои се поделени во повеќе области. Во делот на обезбедување на поголема финансиска независност на единиците на локална власт клучни се барањата за зголемување на зафаќањето од ДДВ за најмалку 10% (сега е 4,5%) во полза на општините; зафаќање од 50% од персоналниот данок на добивка (сега е 3%); зголемување на висината на сите блок дотации; зафаќање од данокот на добивка на игрите на среќа и друго.

„Сакаме финансиска стабилизација за досега преземените надлежности. Потребно ни е да го стабилизираме финансиското работење на нашите институции, а доколку добиеме соодветни финансиски средства спремни сме да преземеме и нови надлежности", истакна претседателот на ЗЕЛС, кој во своето излагање ги презентираше и другите предизвици со кои се соочуваат општините.

Тој укажа на предизвиците во противпожарната заштита, на процесот на легализација на дивоградбите, потоа на потребата од скратување на роковите за донесување на планска документација, поддршката на руралните општини, концентрацијата на капиталните инвестиции, недостатокот на одредени професионални кадри во општинската администрација (урбанисти, архитекти, информатичари)и слично. Шилегов ја потенцираше и потребата локалните власти да се пофокусирани на собирањето на сопствените приходи, особено на данокот на имот, обезбедувањето на негова комплетна база и репроценка на даночната основица. „Владата е подготвена час поскоро да пренесе нови

janë të rëndësishëm për funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Në këtë takim u dakordua edhe korniza kohore dhe dinamika e realizimit të obligimeve. U dakordua të formohet një grup i vogël operativ me përfaqësues nga të dyja anët, të cilët deri në fund të muajit korrik do të punojnë në temat për ndryshime në procesin e decentralizimit, me qëllim të ndërmarrjes së ndryshimeve të mëtejshme ligjore për sigurimin e realizimit të tyre objektiv.

Kërkesat e autoriteteve lokale i prezantoi Kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov në fillimin e takimit. Bëhet fjalë për qëndrimet e sistematizuara të BNJVL-së, të cilat u rishikuan në vitin e kaluar dhe të cilat janë ndarë në më shumë sfera. Në pjesën e sigurimit të pavarësisë më të madhe financiare të njësive të pushtetit lokal kryesore janë kërkesat për rritjen e përfshirjes së TVSH-së në të paktën 10% (tani është 4.5%) në favor të komunave; përfshirja nga 50% e tatimit personal të fitimit (tani është 3%); rritja e shumës së të gjitha bllok dotacioneve; përfshirja nga tatimi i fitimit të lojërave të fatit etj.

- "Duam stabilizim financiar për kompetencat e ndërmarra deri më tani. Duhet ta stabilizojmë punën financiare të institucioneve tona dhe nëse marrim mjete përkatëse financiare jemi të gatshëm të ndërmarrim edhe kompetenca të reja", theksoi Kryetari i BNJVL-së, i cili në fjalimin e tij prezantoi edhe sfidat e tjera me të cilat ballafaqohen komunat.

Ai theksoi sfidat në sferën e mbrojtjes nga zjarri, në procesin e legalizimit të ndërtimeve të egra, pastaj për nevojën e shkurtimit të afateve për miratimin e dokumentacionit planifikues, mbështetjen e komunave rurale, përqendrimin e investimeve kapitale, mungesën e kuadrove të caktuara profesionale në administratën komunale (urbanistë, arkitektë, informaticientë) dhe e ngjashme. Shilegov theksoi edhe nevojën që pushtetet lokale të përqendrohen më shumë në mbledhjen e të ardhurave vetanake, sidomos të tatimit të pronës, sigurimin e bazës së tij të plotë dhe rivlerësimin e bazës tatimore.

надлежности од централно на локално ниво. Со префрлените 51 милион евра за покривање на долговите на општините покажавме како Влада дека сме фокусирани да обезбедиме функционални локални заедници. Средствата што се предвидени од централно ниво за патишта и за водоводи, дополнително ќе им олеснат на општините, средствата од нивните буџети за овие намени да ги насочат кон други потреби. Општините можат да помогнат многу во економскиот развој. Потребна е креативност во обезбедувањето средства преку проекти и рационалност каде што е можно, а интеграциите на нашата држава и отворањето на преговорите со ЕУ ќе значат и достапност на европски фондови и повеќе пари и за инфраструктурата, за животната средина, за проекти во социјалната сфера, образованието, културата. Владата подава рака, но за вистинска функционална децентрализација, потребно е пофункционално и попосветено решавање на работите", потенцираше на средбата, премиерот Зоран Заев, додавајќи дека од особена важност е секоја локална власт да ги јакне сопствените административни капацитети, кои ќе можат ефикасно да го понесат „товарот" на сите промени.

И членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС изнесоа одредени актуелни предизвици, како и предлог-решенија, при што преовладуваше атмосферата на подготвеност за зафаќање со нови надлежности, доколку се создадат адекватни законски услови за нивно непречено спроведување. Стана збор и за можностите за промени во организацијата на локалната самоуправа од едностепена во двостепена; за рамномерниот регионален развој; за префрлање на блок дотациите во една заедничка дотација, со цел поголема самостојност на локалните власти со нивното менаџирање; за јавните претпријатија, за долговите; за обезбедување на мотивирачки фактор за оние локални власти кои успешно ги собираат своите приходи, како и искористување на компаративните предности што ги има секоја општина во сопствена полза.

Средбата заврши со охрабрување од двете страни дека само со ефикасна соработка на локалната и централната власт може да се обезбедат поквалитетни услови и услуги за граѓаните.

- "Qeveria është e gatshme që sa më shpejtë të transferojë kompetenca të reja nga niveli qendror në atë lokal. Me 51 milionë eurot e transferuara për mbulimin e borxheve të komunave treguam si Qeveri se jemi të fokusuar për të siguruar njësi funksionale lokale. Mjetet që janë të parapara nga niveli qendror për rrugë dhe ujësjellës do të jenë një lehtësi shtesë për komunat që mjetet nga buxhetet e tyre për këto qëllime t'i alokojnë për nevoja të tjera. Komunat mund të ndihmojnë shumë zhvillimin ekonomik. Nevojitet kreativitet në sigurimin e mjeteve përmes projekteve dhe racionalitet atje ku ka mundësi. Integrimet e vendit tonë dhe hapja e negociatave me BE-në do të thotë disponueshmëri të fondeve evropiane dhe më shumë para edhe për infrastrukturën, mjedisin jetësor, projektet në sferën sociale, arsimin, kulturën. Qeveria shtrin dorën për një decentralizim të vërtet funksional, nevojitet zgjidhje më funksionale dhe më e përkushtuar e punëve", theksoi në takim Kryeministri Zoran Zaev, duke shtuar se është shumë e rëndësishme që secili pushtet lokal t'i forcojë kapacitetet e veta administrative, të cilat do të mund ta mbajnë në mënyrë efikase "barrën" e të gjitha ndryshimeve.

Edhe anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së prezantuan sfida të caktuara aktuale, si dhe propozim-zgjidhje, kështu që sundonte atmosfera e gatishmërisë për ndërmarrjen e kompetencave të reja, nëse krijohen kushte adekuate ligjore për zbatimin e tyre të ndërprerë. U bë fjalë edhe për mundësitë e ndryshimeve në organizimin e vetëqeverisjes lokale nga ai njëshkallësh në atë dyshkallësh; për zhvillimin e barabartë rajonal; për transferimin e bllok dotacioneve në një dotacion të përbashkët me qëllim të një pavarësie më të madhe të autoriteteve lokale me menaxhimin e tyre; për ndërmarrjet publike; për borxhet; për sigurimin e faktorit motivues për ato autoritete lokale të cilat mbledhin në mënyrë të suksesshme të ardhurat e tyre, si dhe për shfrytëzimin e përparësive krahasuese që i ka çdo komunë në favor të vet.

Takimi përfundoi me inkurajim nga të dyja anët se vetëm me bashkëpunim efikas të pushtetit lokal dhe qendror mund të sigurohen kushte dhe shërbime më cilësore për qytetarët.



## ДЕЛЕГАТИТЕ ОД ЗЕЛС УЧЕСТВУВАА НА ШЕСНАЕСЕТТАТА СЕДНИЦА НА ЗКК ВО БРИСЕЛ

## DELEGATËT E BNJVL-SË MORËN PJESË NË SEANCËN E GJASHTËMBËDHJETË TË KPK-SË NË BRUKSEL



Делегатите од локалната власт од нашата земја, предводени од претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, на 18 јуни, 2019 година учествуваа на шеснаесеттиот состанок на Заедничкиот консултативен комитет помеѓу Република Северна Македонија и Комитетот на регионите на Европската Унија (ЗКК). На средбата присуствуваше и делегација од Министерството за локална самоуправа предводена од министерот, Сухејл Фазлиу, како и Агнеза Руси Поповска, Шеф на Мисија на РСМ при ЕУ. Според вообичаениот редослед на седницата, првата сесија редовно е посветена на напредокот и влијанието на локалната власт во процесот на интегрирањето на нашата земја во Европската Унија.

Пред делегатите на ова тело, кое освен претставници од локалната власт од нашата земја има и претставници од регионалните и локалните власти од земјите членки на Унијата, претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов говореше за предизвиците и за напредокот на децентрализацијата на нашата земја. Притоа, тој изрази оптимизам дека Европската Унија конечно ќе ги отвори портите за нашата земја и ќе го утврди датумот за отпочнување на преговори за влез во ова европско семејство. Тој посочи дека улогата на локалната власт во овој процес е голема и дека за општините во нашата земја следи период на уште поголема одговорност, бидејќи демократијата најмногу се гради на локално ниво.

Благој Бочварски, градоначалник на општина Штип и ко-претседавач на ова тело од македонска страна, при своето уводно обраќање го посочи големото значење на ЗКК за локалните власти во нашата земја. „Овој заеднички Комитет обезбедува континуирана поддршка во насока на јакнење на демократските процеси кај нас, преку размена на добри практики од локалната власт, со цел обезбедување на поадекватен пристап на нашата земја кон Европската Унија", рече Бочварски, посочувајќи дека нашата земја во процесот на пристапување, направи големи чекори во зајакнувањето на правната рамка за заштита на фундаменталните права кои, во голема мера, се во согласност со европските стандарди.

На присутните им се обрати и ко-претседавачот од европска страна, Јасна Грабиќ, градоначалник на општина Требовље, (Словенија) која говореше за големиот напредок на нашата земја на

Delegatët e pushtetit lokal nga vendi ynë, të udhëhequr nga kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov, më 18 qershor 2019 morën pjesë në takimin e gjashtëmbëdhjetë të Komitetit të Përbashkët Konsultativ midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian (KPK). Në takim mori pjesë edhe një delegacion nga Ministria e Pushtetit Lokal, i udhëhequr nga ministri Suhejl Fazliu, si dhe Agneza Rusi Popovska, shef i Misionit të RMV-së pranë BE-së. Sipas renditjes së zakonshme të seancës, sesioni i parë rregullisht i përkushtohet progresit dhe ndikimit të pushtetit lokal në procesin e integrimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Para delegatëve të këtij trupi, i cili përveç përfaqësuesve të pushtetit lokal të vendit tonë ka edhe përfaqësues nga autoritetet rajonale dhe lokale nga vendet anëtare të Unionit, kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov foli për sfidat dhe për progresin e decentralizimit të vendit tonë. Njëkohësisht, ai shprehu optimizëm se Bashkimi Evropian më në fund do t'i hapë dyert për vendin tonë dhe do ta përcaktojë datën për fillimin e negociatave për të hyrë në këtë familje evropiane. Ai theksoi se roli i pushtetit lokal në këtë proces është i madh dhe se për komunat në vendin tonë vijon periudhë e një përgjegjësie akoma më të madhe, sepse demokracia ndërtohet më së shumti në nivel lokal.

Bllagoj Boçvarski, kryetar i Komunës së Shtipit dhe bashkë-kryesues i këtij trupi nga ana e Maqedonisë, gjatë fjalimit të tij hyrës theksoi rëndësinë e madhe të KPK-së për autoritetet lokale në vendin tonë. – "Ky Komitet i përbashkët siguron një mbështetje të vazhdueshme në drejtim të forcimit të proceseve demokratike në vendin tonë, përmes shkëmbimit të praktikave të mira të pushtetit lokal me qëllim të sigurimit të një qasjeje më adekuate të vendit tonë drejt Bashkimit Evropian", tha Boçvarski, duke theksuar se vendi ynë në procesin e qasjes ka bërë hapa të mëdhenj në përforcimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave fundamentale, të cilat në masë të madhe janë në përputhje me standardet evropiane.

Të pranishmëve iu drejtua edhe bashkë-kryesuesi nga ana evropiane, Jasna Grabiq, kryetare e Komunës së Trebovljes

патот кон Унијата, во делот на јакнењето на доброто владеење, како и за позитивниот извештај на Европската Комисија за нашата земја.

Втората сесија беше посветена на тематска дебата „Јакнење на доброто владеење", каде беше нагласено дека проширувањето и демократизацијата на ЕУ повеќе не се гледаат како два паралелни процеси на Балканот. Обновениот пристап на ЕУ кон процесот на пристапување на Западен Балкан предвидува отворање на владеењето на правото, поглавја 23 и 24 на самиот почеток, со што ќе се овозможи поголемо следење на фундаменталните права за време на разговорите за пристапување и повеќе насочената поддршка за придружување на аспирантите на нивниот пат кон стабилни и просперитетни демократии, регулирани со владеењето на правото.

Градоначалничката на општина Македонска Каменица, Соња Стаменкова, презентирајќи го напредокот на локалните власти во нашата земја во делот на родовата еднаквост и заштита на жената, посочи дека голем број општини имаат поголема сензибилност за ова прашање, особено во делот на разбирање и креирање на родово одговорен буџет, но и преку примената на конкретни политики и програми, како резултат на активностите на ЗЕЛС. Стаменковска рече дека Европската повелба за родова еднаквост на Советот на Европа е потпишана од 20 општини во нашата земја и дека нашата земја генерално посветува големи напори за унапредувањето на основните човекови права и целосно искоренување на дискриминацијата по која било основа. Таа посочи дека се прават силни заложби за заштита на жените и борба против насилството и со ратификувањето на Истанбулската конвенција од страна на Собранието на РСМ и преку донесување на амбициозен, но јасен акциски план за нејзино спроведување од сите засегнати страни. ЗЕЛС, како клучна институција во спроведување на активностите на локално ниво, предвидени во Националниот план за имплементирање на Инстанбулската конвенција, во соработка со МТСП, како носител на активноста, ќе учествува во изменување и дополнување на Законот на еднакви можности на мажите и жените.

Во истиот период, паралелни сесии одржаа и заедничките консултативни комитети помеѓу Комитетот на регионите на Европската Унија со Црна Гора, со Србија, со Турција, каде беа дискутирани различни теми, меѓу кои: ЕУ претпристапна помош за Црна Гора; владеење на право во Србија на локално ниво; стратегии за борба против невработеност на млади во Турција и слично.

(Slloveni), e cila foli për progresin e madh të vendit tonë në rrugën drejt Unionit, në pjesën e forcimit të qeverisjes së mirë, si dhe për raportin pozitiv të Komisionit Evropian për vendin tonë.

Sesioni i dytë iu përkushtua debatit tematik "Forcimi i qeverisjes së mirë", ku u theksua se zgjerimi dhe demokratizimi i BE-së nuk shihen më si procese paralele në Ballkan. Qasja e re e BE-së ndaj procesit të pranimit të Ballkanit Perëndimor parasheh hapjen e sundimit të ligjit, kapitujt 23 dhe 24 në vetë fillimin, me ç'rast do të mundësohet një monitorim më i madh i të drejtave fundamentale gjatë negociatave për pranim dhe mbështetja më shumë e targetuar për shoqërimin e aspirantëve në rrugën e tyre drejt demokracive të qëndrueshme dhe prosperuese, të rregulluara me sundimin e ligjit.

Kryetarja e Komunës së Makedonska Kamenicës, Sonja Stamenkova, duke prezantuar progresin e autoriteteve lokale në vendin tonë në pjesën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes së gruas, theksoi se një numër i madh komunash kanë ndjeshmëri më të madhe për këtë çështje, sidomos në pjesën e kuptimit dhe krijimit të buxhetit të përgjegjshëm për barazi gjinore, por edhe përmes zbatimit të politikave dhe programeve konkrete, si rezultat i aktiviteteve të BNJVL-së. Stamenkovska theksoi se Karta Evropiane për barazi gjinore të Këshillit të Evropës është nënshkruar nga 20 komuna në vendin tonë dhe se vendi ynë në përgjithësi bën përpjekje të mëdha për avancimin e të drejtave themelore të njeriut dhe çrrënjosjen e plotë të diskriminimit në cilëndo bazë. Ajo theksoi se po bëhen përpjekje të forta për mbrojtjen e grave dhe luftën kundër dhunës dhe me ratifikimin e Konventës së Stambollit nga ana e Kuvendit të RMV-së dhe me miratimin e një plani ambicioz dhe të qartë aksionar për zbatimin e saj nga të gjitha palët e përfshira. BNJVL-ja si institucion kryesor në zbatimin e aktiviteteve në nivel lokal, në bashkëpunim me MPPS-së si bartës i aktivitetit, do të marrë pjesë në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mundësi të barabarta të burrave dhe grave.

Në të njëjtën periudhë, sesione paralele mbajtën edhe komitetet e përbashkëta konsultative midis Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian me Malin e Zi, Serbinë, Turqinë, ku u diskutuan tema të ndryshme, ndër të cilat: ndihma paraqasëse e BE-së për Malin e Zi; sundimi i ligjit në Serbi në nivel lokal;strategjitë për luftën kundër papunësisë së të rinjve në Turqi etj.



## Пленарна сесија „Денот на проширувањето“

Следниот ден, на 19 јуни 2019 година, сите заеднички комитети, заедно, одржаа пленарна седница „Денот на проширувањето", на тема „Пари преку вредности? Дали подобреното управување води кон локален социо-економски развој", на која пред присутните се обрати и Карл-Хејнз Ламберц (BE/PES), претседател на Европскиот комитет на регионите и Јоханес Хан, европски комесар за европска соседска политика и преговори за проширување. Во Стратегијата за Западен Балкан, усвоена на 6 февруари, 2018 година, Европската Комисија објави шест водечки иницијативи (https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/six-flagship-initiatives-support-transformation-western-balkans_en.pdf) за поддршка на напорите за трансформација во регионот. Две од шесте иницијативи – владеење на правото и социо-економски развој – се од особена важност за локалните и регионалните власти. Владеењето на правото не е академски апстракт, туку апсолутен услов за добро владеење. Социо-економскиот развој е нешто што ќе го очекуваат граѓаните да го видат на крајот од сложените и некогаш болни реформи. На оваа сесија свое обраќање имаше и претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов.

Заедничкиот консултативен комитет меѓу Република Северна Македонија и Комитетот на регионите на Европската Унија (ЗКК) воспоставен е уште во 2008 година, со цел да ја подготвува основата за проширување на ЕУ преку унапредување на политичкиот дијалог и соработка меѓу локалните и регионалните власти.

## Sesioni plenar "Dita e zgjerimit"

Ditën tjetër, më 19 qershor 2019, të gjithë së bashku mbajtën seancën plenare “Dita e zgjerimit” me temë “Paratë përmes vlerave? A çon qeverisja e përmirësuar në zhvillim lokal socio-ekonomik”, në të cilën para të pranishmëve u drejtua edhe Karl-Heinz Lambertz (BE/BES), Kryetar i Komitetit Evropian të Rajoneve dhe Johannes Hahn, Komisioner Evropian për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit. Në Strategjinë për Ballkanin Perëndimor të miratuar më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian publikoi gjashtë iniciativa kryesore (https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/six-flagship-initiatives-support-transformation-western-balkans_en.pdf) për mbështetjen e përpjekjeve të transformimit në rajon. Dy nga gjashtë iniciativat – sundimi i ligjit dhe zhvillimi socio-ekonomik – kanë një rëndësi të veçantë për autoritetet lokale dhe rajonale. Sundimi i ligjit nuk është abstrakt akademik, por kusht absolut për qeverisje të mirë. Zhvillimi socio-ekonomik është diçka që qytetarët do ta presin të shohin në fundin e reformave komplekse dhe ndonjëherë të dhimbshme. Në këtë sesion fjalimin e tij e kishte edhe Kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov.

Komiteti i Përbashkët Konsultativ midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian (KPK) është themeluar që në vitin 2008 me qëllim që ta përgatisë bazën për zgjerimin e BE-së përmes avancimit të dialogut politik dhe bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe rajonale.

## ЛОКАЛНИТЕ ВЛАСТИ ИМААТ ПОТРЕБА ОД ПОВЕЌЕ ФИНАНСИСКИ СРЕДСТВА ЗА СООДВЕТНО СПРОВЕДУВАЊЕ НА НАДЛЕЖНОСТИТЕ

Комисијата за следење на развојот на системот за финансирање на општините на 21 јуни, 2019 година, во просториите на ЗЕЛС ја одржа триесет и четвртата седница. Членовите на ова тело ги разгледаа и ги усвоија предлог –уредбите за методологиите за утврдување на критериумите за распределба на блок дотациите за следната година од повеќе области, односно од областа на културата, од областа на основното и средното образование, како и Предлог – уредбата за методологијата за распределба на приходите од данокот на додадена вредност по општини за 2020 година. Претставниците од локалната власт посочија на недостатокот на средства во блок дотациите за квалитетно спроведување на овие надлежности. Беше нагласена нереалната распределба на средствата од областа на културата, каде тие се префрлаат само за културните објекти кои биле утврдени на стартот на децентрализацијата, а оние кои немаат објекти не добиваат финансии. Недостаток на



## AUTORITETET LOKALE KANË NEVOJË PËR MË SHUMË MJETE PËR ZBATIM ADEKUAT TË KOMPETENCAVE

Komisioni për ndjekjen e zhvillimit të sistemit të financimit të komunave më 21 qershor 2019, në hapësirat e BNJVL-së mbajti seancën e 34-të. Anëtarët e këtij trupi shqyrtuan dhe miratuan draft - rregulloret e metodologjive për përcaktimin e kritereve për shpërndarjen e bllok dotacioneve për vitin e ardhshëm nga më shumë sfera, përkatësisht nga sfera e kulturës, nga sfera e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe Draft – rregulloren e metodologjisë për shpërndarjen e të ardhurave të tatimit të vlerës së shtuar nëpër komuna për vitin 2020. Përfaqësuesit e pushtetit lokal theksuan mungesën e mjeteve në bllok dotacionet për zbatim cilësor të këtyre kompetencave. U theksua shpërndarja joreale e mjeteve nga sfera e kulturës, ku ato transferohen vetëm për objektet kulturore të cilat janë përcaktuar në fillim të decentralizimit, ndërsa ato që nuk kanë objekte nuk marrin financa. Mungesë të mjeteve nga bllok dotacionet ka



средства од блок дотациите има и во областа на образованието. Беше посочено дека и локалните власти треба да пристапат кон спроведување на рационализација на училишната мрежа, бидејќи бројот на наставници во некои општини се зголемува, наспроти намалувањето на бројот на ученици. Забелешка беше упатена и до МОН, кое редовно дава согласност за паралелки со мал број на ученици. Беше предложено да се стави поголем акцент на стручно-техничкото образование и истото да се фаворизира. Во однос на распределбата на приходите од данокот на додадена вредност беа посочени барањата утврдени во систематизираните ставови на ЗЕЛС, каде е посочено зафаќањето од ДДВ да изнесува најмалку 10%. На дневен ред беше ставена и точката за утврдување на предлози и мислења по однос на Извештајот за системот за финансирање на единиците на локалната самоуправа за периодот 2013-2017 година. Беше нагласено дека главната задача на оваа комисија е токму утврдување на препораки и точни насоки што понатаму треба да ги презема Министерството за финансии (МФ) во насока на потребите на локалната власт. Генерално, беше посочено дека локалната власт има недостаток на финансиски средства за спроведување на надлежностите. Освен зголемувањето од зафаќањето од ДДВ, беа посочени и ставовите за зголемување на зафаќањето од персоналниот данок во полза на општините, како и тоа општините да добиваат процент од средствата од данокот на добивка. Потоа, беше посочено дека МФ треба навремено да го доставува буџетскиот циркулар, при што локалната и централната власт треба да водат соодветни буџетски преговори. Голема е потребата и од зајакнување на административните капацитети од областа на финансиите во голем број општини, да се воведе систем на финансиско воедначување, при што од особена важност е дополнително да се помогнат општините кои немаат доволно финансиски средства, особено оние кои имаат незначителни сопствени финансиски извори, немаат природни ресурси и слично, да се упати апел и до локалните власти да ја ревидираат базата на објектите на кои се плаќа данок на имот и да се изврши целосна репроцена на даночната основа за наплаќање на овој данок. Стана збор и за можноста за утврдување на предлог за зголемување на ставката на данокот на имот, како што е регулирано и со закон. Потоа, политиките на Владата за привлекување на странски инвестиции да не бидат на штета на локалните власти, бидејќи тие се немоќни инфраструктурно да уредуваат цели урбанистички зони, во услови кога стапките на продажба на градежното земјиште во државна сопственост, како и висината на комуналиите, се многу ниски. На крајот на седницата беше посочено членовите на Комисијата, меѓу себе, по електронски пат, уште еднаш да ги усогласат и прецизираат овие ставови и потоа утврдената листа да ја достават до Министерството за финансии.

edhe në sferën e arsimit. U theksua se edhe autoritetet lokale duhet të zbatojnë racionalizimin e rrjetit shkollor, sepse numri i mësuesve në disa komuna rritet, kundër uljes së numrit të nxënësve. Vërejtje është drejtuar edhe për MASH-in, e cila rregullisht jep pëlqim për klasa me numër të vogël nxënësish. U theksua se duhet t'i vihet theks më i madh arsimit profesional-teknik dhe të favorizohet i njëjti. Lidhur me shpërndarjen e të ardhurave nga tatimi i vlerës së shtuar, u theksuan kërkesat e përcaktuara në qëndrimet e sistematizuara të BNJVL-së, ku është theksuar se përfshirja nga TVSH-ja duhet të jetë të paktën 10 %. Në rendin e ditës ishte edhe pika për përcaktimin e propozimeve dhe mendimeve lidhur me Raportin për sistemin e financimit të njësive të vetëqeverisjes lokale për periudhën e viteve 2013-2017. U theksua se detyra kryesore e këtij Komisioni është pikërisht përcaktimi i rekomandimeve dhe drejtimeve të sakta të cilat duhet pastaj t'i ndërmarrë Ministria e Financave (MF) në drejtim të nevojave të pushtetit lokal. Në përgjithësi, u theksua se pushteti lokal ka mungesë të mjeteve financiare për zbatimin e kompetencave. Përveç rritjes së përfshirjes së TVSH-së, u theksuan edhe qëndrimet për rritjen e përfshirjes së tatimit personal në favor të komunave, si dhe qëndrimi se komunat duhet të fitojnë një pjesë e mjeteve të tatimit të fitimit. Pastaj u theksua se Ministria e Financave duhet me kohë ta dërgojë cirkularin buxhetor, kështu që pushteti lokal dhe ai qendror duhet të zhvillojnë negociata përkatëse buxhetore. Ka nevojë të madhe për përforcim të kapaciteteve administrative nga sfera e financave në numër të madh të komunave. Të aplikohet një sistem i barazimit financiar, me ç'rast është shumë e rëndësishme që të ndihmohen në mënyrë shtesë komunat të cilat nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, sidomos ato që nuk kanë burime të konsiderueshme vetanake financiare, nuk kanë resurse natyrore dhe e ngjashme. Të apelohet tek autoritetet lokale që ta rishqyrtojnë bazën e objekteve për të cilat paguhet tatimi i pronës dhe të bëhet rivlerësim i tërësishëm i bazës tatimore për mospagimin e këtij tatimi. U bë fjalë edhe për mundësinë e përcaktimit të propozimit për rritjen e shkallës së tatimit të pronës, siç është rregulluar edhe me Ligj. Pastaj, politikat e Qeverisë për tërheqjen e investimeve të huaja të mos jenë në dëm të autoriteteve lokale, sepse ato janë të pafuqishme që ta rregullojnë infrastrukturën e zonave të tëra urbanistike në kushte kur shkallët e shitjes së tokës ndërtimore në pronë të shtetit, si dhe shuma e komunalive janë shumë të ulëta. Në fundin e seancës u theksua që anëtarët e Komisionit, mes tyre, në mënyrë elektronike, edhe njëherë t'i harmonizojnë dhe t'i precizojnë këto qëndrime dhe pastaj listën e përcaktuar ta dërgojnë në Ministrinë e Financave.



## ОПШТИНИТЕ РЕДОВНО ДА ЈА ПЛАЌААТ ЧЛЕНАРИНАТА - АПЕЛИРАШЕ НАДЗОРНИОТ ОДБОР НА ЗЕЛС

Надзорниот одбор на ЗЕЛС на 23 јуни, 2019 година, во Струга ја одржа четвртата седница. Членовите на ова тело го разгледаа извештајот за работа и финансискиот извештај на ЗЕЛС за 2018 година. Присутните беа информирани за структурата на приходите и расходите на ЗЕЛС и начинот на нивната реализација во текот на 2018 година. Особено беше потенцирано дека приходите од членарината во 2018 година значително се подобрени, односно наплатата по овој основ е зголемена за 76,5% повеќе, во однос на 2017 година. Ваквиот забележителен раст е резултат на интензивните активности што ги преземаше ЗЕЛС преку склучување на договори за отплата на рати на заостанатиот долг на општините за реализација на оваа обврска. Исто така, поголем број општини ја искористија можноста овој долг кон ЗЕЛС да го покријат и со средствата што во 2018 година ги добија од централната власт за отплата на дел од заостанатите долгови. Другите приходи се од извршени услуги и донации наменети за спроведување на проекти.

Во однос на расходите на ЗЕЛС, беше посочено дека поголемите трошоци се направени за одржувањето на информатичките системи што ги администрира ЗЕЛС. Дел од трошоците се однесуваат на активности за организација на лобирањето на телата и органите на ЗЕЛС, за печатење на публикации на ЗЕЛС, за материјали за работење, трошоци за одржување на административната зграда на ЗЕЛС, за плати на стручната служба, односно, со еден збор, за реализација на сите активности предвидени во Акцискиот план на ЗЕЛС за 2018 година.

Членовите на Надзорниот одбор беа задоволни од резултатите од наплатата на членарината од општините и изнесоа апел до сите единици на локалната власт да продолжат со утврденото темпо на отплата на заостанатиот долг, како и со навремено плаќање на оваа обврска. Тие нагласија да не се дозволи во иднина повторно да се наталожи долг по овој основ. На крајот од седницата членовите на Надзорниот одбор на ЗЕЛС едногласно ги усвоија: извештајот за работа и финансискиот извештај на ЗЕЛС за 2018 година, со предлог до Генералното собрание да ги усвои на својата прва следна седница.

## KOMUNAT TA PAGUAJNË RREGULLISHT ANËTARËSINË – APELOI BORDI MBIKËQYRËS I BNJVL-SË

Bordi mbikëqyrës i BNJVL-së më 23 qershor 2019, në Strugë mbajti seancën e tij të katërt. Anëtarët e këtij trupi shqyrtuan raportin e punës dhe raportin financiar të BNJVL-së për vitin 2018. Të pranishmit u informuan për strukturën e të ardhurave dhe të dalave të BNJVL-së dhe mënyrën e realizimit të tyre gjatë vitit 2018. Sidomos u theksua se të ardhurat nga anëtarësia në vitin 2018 janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, gjegjësisht arkëtimi i mjeteve për këtë bazë është rritur për 76.5% në krahasim me vitin 2017. Kjo rritje e dukshme është rezultat i aktiviteteve intensive që i ndërmerrte BNJVL-ja përmes lidhjes së kontratave për shlyerjen e borxheve të mbetura të komunave me këste për realizimin e këtij obligimi. Po ashtu, një numër i madh komunash shfrytëzuan mundësinë që ta shlyejnë këtë borxh me mjetet të cilat i morën në vitin 2018 nga pushteti qendror për të shlyer një pjesë të borxheve të mbetura. Të ardhurat e tjera janë nga shërbimet e kryera dhe donacionet të dedikuara për zbatimin e projekteve.

Lidhur me të dalat e BNJVL-së u theksua se shpenzimet më të mëdha janë bërë për mirëmbajtjen e sistemeve informatike me të cilat administron BNJVL. Një pjesë e shpenzimeve ka të bëjë me aktivitete për organizimin e lobimit të trupave dhe organeve të BNJVL-së, për shtypjen e publikimeve të BNJVL-së, për materiale për punë, për shpenzime për mirëmbajtjen e ndërtesës administrative të BNJVL-së, për pagat e shërbimit profesional, gjegjësisht, me një fjalë, për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parapara me Planin aksionar të BNJVL-së për vitin 2018.

Anëtarët e Bordit mbikëqyrës ishin të kënaqur nga rezultatet e arkëtimit të anëtarësisë nga komunat dhe apeluan që të gjitha njësitë e pushtetit lokal të vazhdojnë me ritmin e përcaktuar të shlyerjes së borxheve të mbetura, si dhe me pagesën me kohë të këtij obligimi. Ata theksuan se nuk duhet të lejohet që në të ardhmen të mblidhen borxhe në këtë bazë. Në fundin e seancës, anëtarët e Bordit mbikëqyrës të BNJVL-së miratuan njëzëri raportin e punës dhe raportin financiar të BNJVL-së për vitin 2018, duke i propozuar Kuvendit gjeneral që t'i miratojë ato në seancën e tij të parë të ardhshme.



# ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

# BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT




**КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ**

тел. +389 (0)2 30 99 033 | факс: +389 (0)2 30 61 994

ул. "Копенхагенска" бр. 5, п. фах 32, 1000 Скопје, Република Северна Македонија

contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

**INFORMACIONE PËR KONTAKT:**

tel. +389 (0)2 30 99 033 | faks: +389 (0)2 30 61 994

rr. "Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk